

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"OPTO GENOVA" SHPK**

**KREU I
EMERTIMI-OBJEKTI-QENDRA-KOHEZGJATJA**

Neni 1-Formimi i shoqërisë

Sot në Tiranë në datën 25.11.2024, themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “OPTO GENOVA” SHPK, me vullnetin e lirë të ortakëve, Bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” Shtetasit Shqiptarë:

- a) **KLEVES JAZXHI**, i biri i Gëzim, i datëlindjes 27.05.1972, lindur në Elbasan me mjet identifikimi nr. H20527153T, me shtetësi Shqiptare, dhe banues në Tiranë.
- b) **EVA JAZXHI**, e bija e Rrapush, e datëlindjes 06.11.1979, lindur në Cerrik, me mjet identifikimi nr. H96106047H, me shtetësi Shqiptare, dhe banuese në Tiranë.
- c) **TOMAS JAZXHI**, i biri i Kleves, i datëlindjes 25.11.2004, lindur në Itali, me mjet identifikimi nr. K41125046N, me shtetësi Shqiptare, dhe banues në Tiranë.

Janë ortakë të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "OPTO GENOVA" SHPK Shoqëria është person juridik dhe do ushtrojë veprimtarinë në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

NENI 2–Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

2.1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë si vijon:

- 2.1.1 Veprimtari në fushat : Optikë, Optometri, Okulistikë, Imazheri, Telemjekësi, Kujdes ndaj Shëndetit (jo-publik), Profilaksi, Edukim Shëndetësor, Trajnime Profesionale.
- 2.1.2. Import, eksport, tregti me shumicë dhe pakicë :
 - syze optike, syze dielli, skelete optike, lente oftalmike, xhama optikë, lente me kontakt ;
 - produkte, software, aksesore, materiale, instrumente, makineri, aparatura, pajisje ekzaminuese të nevojshme për realizimin e objektit të veprimtarisë.

Neni 3-Kohëzgjatja e veprimtarisë

3.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

3.1. Me vendim të ortakëve afati i mësipërm mund të ndryshojë ose shoqëria mund të shkrihet.



Neni 4-Vula e shoqërisë

Shoqëria do të ketë vulën e vet në formën e përcaktuar nga ortakët.

Neni 5-Selia e shoqërisë

- 5.1. Shoqëria “OPTO GENOVA” SHPK ka qendrën në Tiranë me adresë: Rr. “Myslym Shyri”, P. 9/1, Tiranë.
- 5.2. Shoqëria do të ushtrojë gjithë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 5.3. Shoqëria mund të çeli seli të tjera të dyta, degë, përfaqësimi si dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj sipas legjislacioneve në fuqi.


KREU II KAPITALI-KUOTAT-ORTAKËT

Neni 6-Kapitali i regjistruar

- 6.1. Kapitali i shoqërisë është LEKË 100.000 (njëqind mijë) dhe është kapital i ortakëve i ndarë në kuota respektivisht në:
 - 6.1.1. Kleves Jazxhi zotërues i 40% të kuotave të shoqërisë
 - 6.1.2. Eva Jazxhi zotëruese e 40% të kuotave të shoqërisë
 - 6.1.3. Tomas Jazxhi zotërues i 20% të kuotave të shoqërisë
- 6.2. Kapitali është i ndarë në 2 kuota me vlerë LEKË 40.000 (dyzet mijë) dhe 1 kuotë me vlerë LEKË 20.000 (njëzet mijë) respektivisht:
 - 6.2.1. Kleves Jazxhi 1 kuotë me vlerë 40.000 LEKË
 - 6.2.2. Eva Jazxhi 1 kuotë me vlerë 40.000 LEKË
 - 6.2.3. Tomas Jazxhi 1 kuotë me vlerë 20.000 LEKË
- 6.3. Kapitali i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet me vendim të ortakëve.

Neni 7-Transferimi i kuotave

- 7.1. Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.
- 7.2. Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre me vendim të ortakëve mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit; (si personave që kanë lidhje gjaku me ortakët ashtu edhe të tjerëve pa lidhje gjaku)
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të behet me shkrim dhe e noterizuar.



Neni 8-Ortakët

- 8.1. Shoqëria zotërohet nga tre ortakë dhe të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga te tre ortakët. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
- 8.2. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
 - 8.2.1. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë së veprimtarisë;
 - 8.2.2. Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - 8.2.3. Investimet e reja;
 - 8.2.4. Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 8.3. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria vendos ndryshe.

KREU III DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 9-Drejtimi dhe Administrimi

9.1 Shoqëria tregtare "OPTO GENOVA" SHPK do drejtohet nga një administrator që emërohet me vendim të ortakëve.

Administrator i Shoqërisë duke filluar nga data e sotme për pesë vitet në vazhdim (25/11/2024 deri 24/11/2029) do të jetë ortaku EVA JAZXHI

9.2 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- 9.2.1. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortakët;
- 9.2.2. përfaqëson shoqërinë tregtare;
- 9.2.3. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- 9.2.4. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakëve për miratim;
- 9.2.5. krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- 9.2.6. kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- 9.2.7. raporton përpara ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



Tomar
Jazxhi



9.3 Ortakët mund ta shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

9.3. Administratori do shpërblehet sipas përcaktimit të ortakëve në përputhje me parashikimin e nenit 97 të ligjit nr.9901 date 14.04.2008. "Për Shoqëritë Tregtare".

9.5 Administratori ka të drejtë të caktojë dhe revokojë persona të tretë në mungesë dhe për llogari të tij.

Neni 10-Kontrolli i brendshëm

10.1. Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një kontabël të miratuar, i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në rregull e detyrës së tij.

Neni 11-Bilanci dhe të ardhurat

11.1. Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti përveç rasteve e urdhrave të veçanta të ortakëve të saj. Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME.

11.2. Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas përcaktimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për përdorim Ortakëve të saj.

Neni 12-Shpërbërja e shoqërisë

12.1. Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për një ose më shumë nga shkaqet e parashikuara nga neni 99 të ligjit nr.9901 date 14.04.2008. "Për Shoqëritë Tregtare".

12.2. Në rast shkrirje të shoqërisë, Ortakët vendosin mbi mënyrat e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatorë duke iu përcaktuar edhe detyrat.

12.3. Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi:

SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER.

Administratori regjistron prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 13-Dispozitat përfundimtare

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do i referohet plotësisht të bëra nga ORTAKET.

Shoqëria “OPTO GENOVA” SHPK do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar dhe normat e këtij statuti. Ky statut nënshkruhet prej ortakëve në datë 25/11/2024.

ORTAKET

EVA JAZXHI
(emër, mbiemër, firmë)



KLEVES JAZXHI
(emër, mbiemër, firmë)



TOMAS JAZXHI
(emër, mbiemër, firmë)

